Tiranë, 4 May 1939

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1147

Fort i ndershem Im Lengj.

Po ju shkruanj këtë letrë të dytë passi e mblothuna para vehta, dhe pas posulles që ju dërgova bashkë me zarfin e dokumentave, të cilat besonj se i kini marrë.

Nuk di se si vini tani me punët t'nejá atje. Besonj që të jenë shtruar. Tashi më tepër se kurdoherë duhet të marrim pjesë të bashkuar në zhvillimin e jetës së re dhe me valën përparimtare. Këto bisedova pardje edhe me Shk. T. Xhafer Ypi, ministrin e Drejtësis, i cili si mik i juaj çfaqi po këtë dëshirë, që t'i mbani besnikët me njëjësi dhe dashuri të bashkuarë, pa mëriza dhe egoisma personale, që janë çkatërimtare. ~~Ai tha se~~

I thashë Xhafer beut se duhet ndaluar Iungot Kristofori e shokët nga lodrat e tyre satanike dhe më tha se e kishte bërë këtë porosi edhe se do t'a vështrojë; e pengoi, tha, dërgimin e ... inspektorit, siç kishin vendosur më parë, po duhet, tha, që edhe Evlogji ynë t'a shtrojë punën më mirë dhe shtoi se ju ka dërguar edhe letrë.

Me kaq besonj se më morni vesh dhe uronj t'ju dëgjonj fjalën e mirë.

Lajmet e këtushme besonj se i mësoni nga gazetat dhe nga udhëtarët. Jemi mirë. Në Shtypin t'onë kanë filluar për organizimin e ri dhe jemi në me gjemba gjer sa të ndahet puna e... fati.

Nga Violeta s'kam marrë letrë që prej dy javësh. Për Paolinën kish qenë në Larisa. I dërgova te

hollat tere dhe mbetet tani te paguajme vetem muajin e fundit. Po u-be keq per kete, se ka rene kursi me drahmi dhe çeke nuk priten kollaj; s'di se do t'a bej, te shohim. Mos kini ujeri q'andej qe do te veje Solenik?

Z. Naçi te fala. Ashtu edhe mikut Z. Kondi, ~~ndonse~~ s'me ka kujtuar, po ka arsye se ndodhe ngjarjet e papritura.

Tere familja ime ju puth doren me nderime. Jemi mire me shendet.

Per Visarionin a e mesuate episodin q'i ndodhi?.. Tashi ka ardhen rri ne qytet brenda.

Dhiako-Theodhulos te fala te perzemerta.

Me dashuri
Nipi juaj
Vasili